



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	29/05/2025		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/04-19774		

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: 17.04.2024
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 3
<u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak ☒ Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐
Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>17</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☒ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da ☒ Jo / Ne ☐ <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë.</i>

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju
Pwrfaqwsues nga KFOR LMTK

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Mbledhja u udhwheq nga Nwnkryetari i Komunws, z.Arben Shala

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhjen e mbajtur me datë 17.04.2025 u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 20.02.2025:
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2025/02/Proceverbal-i-KKSB-se-date-30.01.2025.pd>.
2. Siguria e përgjithshme në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni i Policisë në Drenas
3. Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e tretë(3) për këtë vit ku të pranishëm ishin 15 anëtarë të KKSB-s, përfaqësuesi na KFORI LTMK dhe përfaqësuesi nga MPB, Departamenti për Siguri Publike, z.Dardan Duraku si dhe anëtarë nga ekzekutivi komunal.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 20.02.2025: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2025/02/Proceverbal-i-KKSB-se-date-30.01.2025.pd>.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar është miratuar pa vërejtje apo komente nga anëtarët e KKSB-së.

2. Siguria e përgjithshme në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni i Policisë në Drenas. Komandanti i Policisë, Driton Morina para anëtarëve paraqiti një raport të përmbledhur të Sigurisë në

Komunën e Drenasit për periudhën tre mujore të vitit 2023. Në mbledhje u theksua se situata e përgjithshme e sigurisë është e qetë, pa ndonjë incident të theksuar. Ndërsa, u raportua se më shqetësuese është rastet e vjedhjeve. Komandanti Morina njoftoi se në tremujorin e parë janë evidentuar 13 raste të vjedhjeve të zakonshme dhe 25 raste të vjedhjeve të rënda. Kryesisht vjedhjet janë kryer në shtëpitë e mërgimtarëve të cilat janë pa mbikëqyrje, por edhe disa raste në qytetin e Drenasit dhe Komoranit. Në këtë rast, ata janë duke e zbatuar një plan operativ në kohëzgjatje një muaj, që zhvillohet nga ora 06:00 deri 04:00 të mëngjesit, me qëllim parandalimin e vjedhjeve. Sa i përket dhuna në familje, në krahasim me tremujorin e vitit të kaluar ka pasur një rritje nga 7 raste vitin e kaluar në 16 raste këtë vit. Aksidentet në komunikacion: Janë evidentuar gjithsej 188 raste.

Skender Bogiqi nga KLSP në këtë pikë ngriti çështjen e nënkalimit të Llapushnikut dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda e njoftoi se për këtë kërkesë të ripërsëritur e kanë ngritur në ministri. Lidhur me takimet në ministri për çështjet që ndërlidhen me trafik, komandanti Morina kërkoi që të njoftohen edhe ata në mënyrë që të jenë të pranishëm pasi po ka telashe pastaj në trafik. Gjithashtu, i pyetur z.Morina për nënstacionin policor në Komoran, ai tha se janë duke u zhvilluar punimet dhe shpresojnë të përfundojnë sa më shpejtë. Edhe Meriton Sopi e ngriti çështjen e mbeturinave nga rruga që është punuar Llapushnik-Berishë. Ai theksoi se kompania ka lënë mbeturina nuk i ka hequr në pjesën e “Bokave”. Gjithashtu ai shprehu gjithashtu shqetësimin për gjendjen jo të mirë të pikës grumbulluese në Llapushnik për shkak të hedhjes së mbeturinave tjera si plastike e ndezje gomave. Drejtori Nexhmedin Gruda theksoi se bashkë me inspektoratin po mundohen me parandalu dhe se çdo javë me kompaninë e pastrojnë.

Arben Nika tha se si organizatë kanë punuar në një raport për knaqëshmërinë e qytetarëve me Policinë në Rajonin e Prishtinës, dhe se, Komuna e Drenasit është vlerësuar si më e mira në Rajonin e Prishtinës. Ky vlerësim është pozitiv dhe tregon për një nivel të mirë të bashkëpunimit dhe besimit të qytetarëve ndaj policisë. Ai adresoi edhe disa çështje si : Djegia e mbeturinave është një problematikë e vazhdueshme. Kërkohet angazhim më i madh nga inspektorati.

- Gjatë punimeve rrugore, janë hapur gropa pa shirita paralajmërues, duke rrezikuar sigurinë publike, po edhe punëtorët e kompanive jo të siguruar.

- Problematika me humbjen e ujërave nëntokësorë vazhdon të jetë evidente.

- Në tri shkolla në Poklek, meqë ka numër të madh të nxënësve – u propozua që hyrja e Gjimnazit të ndryshohet për të zvogëluar frekuentimin e rrugës kryesore dhe për mirësuar sigurinë.

Konkluzione dhe rekomandime

- Të forcohen masat e parandalimit të vjedhjeve, zbatimi i Planit Operativ të Policisë
- Të kërkohet mbikëqyrje më e rreptë nga inspektorati për punimet në infrastrukturë.
- Parandalim i hedhjes së mbeturinave jo inerte në deponinë në Llapushnik, marrja e masave për një vend tjetër për deponi
- Të rritet bashkëpunimi me Policinë, Ministrinë dhe qytetarët për adresimin e çështjeve të sigurisë.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi
 (emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)


[Signature]

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

[Signature] **Ramiz Lladrovci**

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

[Signature]
 Nënshkrimi / potpis



Data e aprovimit / Datum odobravanja: 29.05.2025

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
 - Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
 - Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
 - Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.*